


KAPITULLI I TETË

**VIZION I RI
PËR RININË**

Gjej qëllimin, ndrysho jetën tënde



Kur takojmë një njeri për herë të parë, jemi kuriozë të dimë se kush është ai apo ajo. Zoti ka të njëjtin kuriozitet për çdo qenie njerëzore. Ai është veçanërisht kurioz rreth të rinjve, dhe njohja e tyre nga afër i sjell një gëzim të veçantë . Pse ndodh kështu? Sepse rinia është periudha më e rëndësishme dhe më e bukur e jetës tonë. Kjo periudhë duhet të jetë një kohë qetësie, kur dikush përgatitet për të ardhmen. Procesi i rritjes deri në pjekuri është një bllok ndërtues, që hap rrugën për një epokë të re.

Është e vështirë të gjesh sot të rinj, që janë të pasionuar për jetën e tyre. Mund të shohim kaq shumë të rinj që, duke mos pasur një synim apo qëllim për jetën e tyre, thjesht enden më kot. Të gjithë udhëheqësit e mëdhenj në histori kanë pasur një qëllim të caktuar në jetë që nga koha kur kanë qenë fëmijë. Që nga fëmijëria ata e kanë ushqyer atë qëllim brenda zemrës dhe kanë vënë në lëvizje një energji të madhe për ta arritur atë. Kanë qenë në gjumë apo duke lozur me shokët, këta lidera të mëdhenj e drejtuan çdo energji rinore drejt përgatitjes së skenës, ku ata do të qëndronin në të ardhmen. A është kjo mënyra si po jetoni edhe ju?

Të gjithë u krijuam për t'u bërë gra dhe burra të mëdhenj. Zoti nuk na dërgoi në këtë botë pa një qëllim. Kur na krijoi, Zoti investoi dashurinë e Tij të plotë tek secili prej nesh. Pra, të gjithë u krijuam për mad-

hështi. Meqë Zoti ekziston, ne mund të përmbushim çdo gjë. Unë u bëra një person tërësisht tjetër kur fillova të dua Zotin. E desha njerëzimin më shumë se veten dhe isha më i shqetësuar për problemet e të tjerëve se për problemet e familjes sime. Desha gjithçka që ka krijuar Zoti. I desha me gjithë shpirt pemët nëpër kodra dhe peshqit në ujëra. Shqisat shpirtërore u zhvilluan dhe munda të shquaj punën e dorës së Zotit në të gjitha gjërat e krijimit.

Ndërsa ndryshoja zemrën time në përputhje me dashurinë e Zotit, forcova edhe trupin, me qëllim që të përmbushja misionin tim. Doja të isha gati të shkoja kudo dhe kurdoherë që të më thërriste Zoti. Luajta futboll dhe u mora me boks, me disa arte marciale koreane, dhe me Uanhuado, një formë arti marcial që e zhvillova vetë. Në uanhuado sportisti lëviz lehtë trupin në formë rrethore, pothuajse sikur të ishte duke vallëzuar. Ajo bazohet në parimin, sipas të cilit lëvizja rrethore prodhon fuqi më të madhe sesa lëvizja në vijë të drejtë.

Madje, edhe tani e filloj çdo ditë me ushtrime për shtrijjen e muskujve dhe kyçeve dhe m një ushtrim frymëmarrje, që e kam krijuar vetë. Nganjëherë, kur jam duke udhëtuar rreth botës nëpër turne fjalimesh, mund të mos kem kohë për këto ushtrime në mëngjes. Megjithatë, do ta gjej kohën, ndonjëherë edhe kur jam në banjë. Nuk kam lënë asnjë ditë pa bërë ushtrime. Kur isha i ri, tridhjetë minuta në ditë ishin të mjaftueshme, por tani që jam i moshuar e kam çuar në një orë në ditë.

Në vitin 2008 u përfshiva në një aksident me helikopter. Befas helikopteri u rrethua nga një re e zezë shiu dhe, brenda një çasti, u përplas me një faqe mali. Helikopteri u kthye përmbys dhe unë mbeta i varur me kokë poshtë në rripin e sediljes sime. Instinktivisht u kapa fort pas mbështetëseve të krahëve në të dyja anët e karriges. Nëse nuk do të kisha qenë aq i zellshëm për ushtrimet fizike, mendoj se do të kisha thyer

kockat e legenit në çastin që u ktheva me kokë poshtë. Trupi është një enë që duhet të mbajë shpirt të shëndetshëm. Është e rëndësishme që të stërvitemi me zell për të mbajtur në formë trupin.

Pak studentë shkojnë në shkollë sepse u pëlqen të studiojnë. Ata, zakonisht, shkojnë sepse u thonë prindërit, por jo se mezi presin të studiojnë. Por, ndërsa vazhdojnë të studiojnë, gradualisht mësojnë se si t’u pëlqejë ai. Prej këtu, ata fillojnë të studiojnë vetë dhe ta gjejnë vetë rrugën e tyre. Interesi për të mësuar është shenjë e pjekurisë.

Prindërit nuk kanë durimin të presin derisa fëmijët të piquen mjaftueshëm sa të studiojnë me dëshirën e tyre. Ata u thonë: “Duhet të studiosh. Të lutem, mblidhe mendjen dhe studio”, dhe, kështu, i vënë ata nën presion. Prindërit e bëjnë këtë sepse e dinë, që fëmijët duhet të studiojnë që të përgatiten për të ardhmen. Ata kanë merak se, nëse fëmijët nuk studiojnë sipas nivelit të përshtatshëm për moshën e tyre, do të jenë të papërgatitur në të ardhmen.

Megjithatë, ekziston diçka më e rëndësishme se studimet, për t’u përgatitur për të ardhmen. Para se të përqendrohen në mënyrë të pakushtëzuar në studimet, të rinjtë duhet të kuptojnë se çfarë duan të bëjnë në jetë. Ata duhet të jenë të vendosur ta përdorin talentin për të ndihmuar botën, më shumë se, thjesht, për t’i shërbyer vetes. Shumë të rinj, sot, duket se studiojnë vetëm për interesin e tyre.

Po të mos keni një qëllim në jetë, studimeve tuaja do t’u mungojë pasioni i nevojshëm për lumturinë.

Njëherë u ndesha me një student korean, që punonte shumë për detyrat e anglishtes. E pyeta: “Pse punon kaq shumë për të mësuar anglisht?”.

Ai u përgjigj: “Që të hyj në universitet”.

A ka gjë më të cekët se kjo? Hyrja në universitet nuk është një qëllim.

Universiteti është një vend ku shkohet dhe ku studiohen lëndë të veçanta për një objektiv më të gjerë. Ai nuk mund të jetë objektiv në vetvete.


Gjithashtu, mos e përkufizoni qëllimin e jetës suaj me sasinë e parave që dëshironi të fitoni. Nuk kam marrë kurrë rrogë, por ia kam dalë të ha dhe të mbetem gjallë. Paraja është një mjet me të cilin bëhet diçka, por nuk është qëllim. Para se të fitoni paratë, bëni planin se për çfarë do t'i shpenzoni. Paraja e fituar pa ndonjë objektiv të paraprak do të priset shpejt.

Zgjedhja e punës, a profesionit, që do të bëni nuk duhet të bazohet vetëm në talentet dhe interesat tuaja. Nëse bëheni zjarrfikës, bujk apo një futbollist, kjo është puna juaj. Por, ajo për të cilën e kam fjalën, e tejkalon profesionin tuaj. Çfarë lloj jete do të bëni sikur të ishit futbollist? Si do të jetonit si bujk? Cili është objektivi juaj në jetë?

Të vendosësh objektivin do të thotë t'i japësh kuptim jetës që do të bësh. Nëse do të bëheni bujk, atëherë duhet të vendosni një objektiv: të provoni metoda të reja kultivimi, të zhvilloni specie më të mira drithi apo të ndihmoni në zhdukjen e urisë. Nëse doni të bëheni futbollist, atëherë vendosni një objektiv me kuptim, si për shembull: lartësimi i imazhit të vendit tuaj në botë, ose ndërtimi i fushave të futbollit, që do të ushqejnë ëndrrat e fëmijëve të privuar ekonomikisht.

Që të bëhesh futbollist i nivelit botëror duhet një punë e pabesueshme. Nëse nuk keni një qëllim të përcaktuar në zemër, nuk do të jeni në gjendje të duroni stërvitjet e vështira, që kërkohen për të arritur majën. Vetëm nëse keni një objektiv, ju do të keni fuqi të vazhdoni kursin tuaj dhe të bëni një jetë më të mirë nga ata përreth jush.

Përqafo botën



Vendosja e një qëllimi në jetë ngjan me mbjelljen e një peme. Nëse mbillni një pemë hide në oborrin e shtëpisë, do të keni hide në shtëpi. Nëse mbillni pemë molle në kodrën prapa shtëpisë, atëherë ato do të prodhojnë mollë. Mendohuni me kujdes mbi zgjedhjet e qëllimeve tuaja dhe, se, ku synoni t'i mbillni ato. Në varësi të qëllimit që zgjidhni dhe vendit ku e mbillni, mund të bëheni një pemë hide në Seul ose një pemë molle në Afrikë. Ose mund të bëheni një pemë palme në Paqësorin jugor. Qëllimi që mbillni do të japë fruta në të ardhmen. Mendohuni mirë se ku është vendi më i mirë për të mbjellë qëllimin tuaj, në mënyrë që të japë frutat më të mira.

Kur vendosni qëllimin, sigurohuni që keni marrë parasysh gjithë botën. Merrni parasysh Afrikën, e cila vazhdon të vuajë nga varfëria dhe sëmundjet. Merrni parasysh Izraelin dhe Palestinën, ku njerëzit vazhdojnë të drejtojnë armët ndaj njëri-tjetrit dhe luftojnë për çështje besimi. Merrni parasysh Afganistanin, ku njerëzit mezi mbijetojnë duke kultivuar bimë hashashi, e cila përdoret për të bërë droga dëmprurëse. Merrni parasysh Shtetet e Bashkuara, të cilat e kanë futur ekonominë botërore në krizë me lakminë dhe egoizmin e tyre ekstrem. Merrni parasysh Indonezinë, Haitin dhe Kilin, të cilët vuajnë nga tërmete të vazhdueshme dhe dallgë baticore. Imagjinojeni veten në kontekstin e

atyre vendeve dhe mendoni cili vend dhe cila situatë do të ishte më e përshtatshme për ju. Mund të ndodhë të jeni më të përshtatshëm për në Indi, ku mund të shpërthejë një konflikt i ri fetar. Ose mund të jeni në Ruanda, e cila lëngon në thatësi dhe uri.

Kur të vendosin qëllimin, studentët nuk duhet të jenë aq budallenj sa të thonë se, meqë vendi i tyre është i vogël, si Koreja, qëllimet tuaja nuk vlejnë. Në varësi të asaj që bëni, nuk ka kufij sa i madh mund të bëhet një komb. Madje, kufijtë e tij kombëtarë mund të zhduken. Nëse jeni duke bërë punëra të mira në kontinentin e madh të Afrikës, apo në vendin e vogël të Koresë, qëllimi juaj nuk duhet të kufizohet nga madhësia. Qëllimet tuaja duhet të jenë të lidhura me vendin ku talentet tuaja mund të kenë ndikim më të madh. Prandaj duhet ta mendoni botën sikur të ishte skena juaj, ndërkohë që vendosni se çfarë dëshironi të bëni në jetë. Nëse veproni kështu, ju do të gjeni shumë më tepër gjëra për të bërë se ç'kishit ëndërruar fillimisht. Keni vetëm një jetë për të jetuar, prandaj përdoreni për të bërë diçka, për të cilën bota ka nevojë. Nuk do ta zbuloni dot thesarin e fshehur në ishull, pa aventurë. Ju lutem, mendoni përtej kombit tuaj dhe mendojeni botën sikur të ishte skena ku do të vendosni qëllimet tuaja.

Gjatë viteve 1980, dërgova shumë studentë koreanë universitarë në Japoni dhe në Shtetet e Bashkuara. Unë doja që ata të largoheshin nga Koreja, ku çdo ditë lëshohet mbi ta gaz lotsjellës, dhe t'i lejoja të shikonin një botë më të gjerë, me më shumë larmi. Bretkosa, që jeton në fundin e pusit, nuk e kupton që ekziston një botë më e madhe jashtë atij pusi.

Kam menduar globalisht, madje, para se kjo fjalë të hynte në gjuhën koreane. Arsyeja për të cilën shkova të studioja në Japoni, ishte që të shikoja një botë më të gjerë. Arsyeja për të cilën desha të punoja për Kompaninë Elektrike të Mançurisë, në Hailar, Kinë dhe të mësoja gjuhën

kineze, ruse dhe mongole, madje, edhe para se të çlirohej Koreja, ishte që të bëhesha i aftë të jetoja si qytetar global. Madje, edhe tani fluturoj me aeroplan në shumë vende të botës.

Nëse do të më duhej të vizitoja çdo ditë nga një vend të ndryshëm, do të më duheshin më shumë se gjashtë muaj për t'i vizituar të gjitha. Njerëzit jetojnë në shumë vende dhe rrethana të ndryshme. Ka vende ku nuk ka ujë me se të ziesh orizin, ndërkohë që në vende të tjera ka ujë me tepricë. Disa vende nuk kanë elektricitet, ndërkohë që vende të tjera nuk janë në gjendje të konsumojnë të gjithë energjinë që prodhojnë. Ka shumë raste ku diçka mungon në një vend, por është me tepricë në një vend tjetër. Problemi është se nuk ka mjaftueshëm njerëz që të merren me shpërndarjen e barabartë të të mirave.

E njëjta gjë është e vërtetë me lëndët e para. Disa vende kanë me bollëk minerale qymyrguri dhe hekuri, të grumbulluara pargje sa një mal. Ata nuk kanë nevojë as të gërmojnë thellë në tokë. Gjithçka duhet të bëjnë është: të fusin lopatën në pargun e mineralit, qymyrgurit apo hekurit, që është lehtësisht e arritshme. Megjithatë, Koreja ka mungesë të madhe në rezervat e mineralit të qymyrgurit dhe hekurit. Për të gjetur qymyr antracit, na duhet të rrezikojmë jetën, duke shkuar disa mijë metra nën tokë.

Afrika ka shumë vende ku bananet rriten me bollëk, në mënyrë natyrore, dhe kjo mund t'i shpëtojë njerëzit nga vdekja prej urisë. Por mungon teknologjia dhe mënyra për të shkuar tek tokat pjellore, kështu që plantacionet e bananeve të krijuara janë të pamjaftueshme. Klima e Koresë nuk është e përshtatshme për rritjen e bananeve, e megjithatë, ne rrisim banane. Teknologjia e përdorur në Kore mund të ishte shumë e dobishme për zgjidhjen e problemit të varfërisë në Afrikë. Është e ngjashme me mënyrën se si teknologjia e Koresë së Jugut, në mbjelljen

e misrit, ka ndihmuar për lehtësimin e zisë së bukës në Korenë e Veriut.

Fraza, “udhëheqës global” është tani në modë në Kore. Njerëzit thonë se duan të mësojnë rrjedhshëm anglishten dhe të bëhen udhëheqës globalë. Por, të bëhesh udhëheqës global, nuk është thjesht çështje e zotërimit mirë të anglishtes. Aftësia për të komunikuar në anglisht nuk është gjë tjetër veçse një mjet. Udhëheqësi i vërtetë global duhet të jetë i aftë të përqafojë në gjirin e tij botën. Atij që nuk i interesojnë problemet e botës, nuk mund të bëhet udhëheqës global, sado mirë të komunikojë në anglisht.

Për të qenë udhëheqës global, njeriu duhet të mendojë për problemet e botës sikur të ishin të tijat dhe të ketë shpirtin nismëtar, që nevojitet për të gjetur zgjidhje të vështira. Dikush, që është i lidhur pas të ardhurave fikse dhe të sigurta, ose që ëndërron të ketë një pension kur të plakët, dhe një jetë të rehatshme familjare, nuk bëhet dot udhëheqës global. Që të bëhet i tillë, njeriu duhet ta konsiderojë mbarë botën sikur të ishte kombi i tij, gjithë njerëzimin sikur të ishin vëllezërit dhe motrat e tij, dhe jo të shqetësohet tej mase, ngaqë nuk di se ç’mund t’i sjellë e ardhmja.

Çfarë janë vëllezërit dhe motrat? Pse na ka dhënë Zoti vëllezër dhe motra? Ata simbolizojnë qeniet njerëzore në mbarë botën. Përvoja e dashurisë ndaj vëllezërve dhe motrave tona në familje na mëson si të duam shokun dhe patriotin tonë, dhe si të duam njerëzimin. Dashuria për motrën dhe vëllanë shpërndalet në këtë mënyrë. Familja, anëtarët e së cilës duan njëri-tjetrin, është modeli që tregon se si mbarë njerëzimi mund të jetojë së bashku në harmoni. Dashuria tyre do të thotë, që ata janë të gatshëm të rrinë pa ngrënë, nëse është e nevojshme, në mënyrë që një vëlla ose motër të mund të hajë. Një udhëheqës global është ai që do njerëzimin, njëlloj siç do familjen e tij.


Ka kaluar pak kohë që kur kemi dëgjuar për herë të parë frazën “fshat global”. Megjithatë, toka gjithmonë ka qenë një komunitet i vetëm. Nëse qëllimi i një personi në jetë ka qenë të diplomohet në një universitet, të fillojë një punë në një kompani, që do t’i japë një rrogë të lartë, dhe të bëjë një jetë të sigurt, atëherë ai person do të ketë suksesin e një harabeli. Por, nëse ia dedikon jetën ndihmës për refugjatët në Afrikë, ai do të ketë suksesin e një luani. Rruga që zgjidhet varet nga zemra e individit.

Edhe pse në moshën nëntëdhjetëvjeçare vazhdoj të udhëtoj anembanë botës. Refuzoj të çlodhem dhe të heq dorë nga misioni im. Bota është tamam si një organizëm gjithmonë në ndryshim. Lindin gjithmonë probleme të reja. Shkoj në qoshet më të errëta të botës, aty ku këto probleme ekzistojnë. Këto nuk janë vende me panorama mahnitëse dhe vende çlodhëse, por unë ndihem i lumtur në vende që janë të errëta, të vështira dhe të vetmuara, sepse atje është vendi ku mund të përmbush misionin, qëllimin dhe detyrën time.

Shpresa ime është që Koreja të prodhojë udhëheqës globalë, në kuptimin e vërtetë të fjalës. Shpresoj të shikoj më shumë udhëheqës politikë, që të drejtojnë Kombet e Bashkuara për të përmbushur qëllimin e tyre, dhe më shumë kryediplomatë që do të ndalojnë luftërat në zonat e konfliktit. Shpresoj të shikoj më shumë njerëz si Nënë Tereza, që të kujdesen për ata që enden dhe vdesin nëpër rrugë. Shpresoj të shikoj udhëheqës të paqes, që do të trashëgojnë misionin tim të gjetjes së zgjidhjeve të reja nga toka dhe deti.

Pika e fillimit është të kesh një ëndërr dhe një qëllim. Ju lutem, kini shpirt aventurieri dhe nismëtari. Ëndërroni gjëra që të tjerët nuk guxojnë t’i imagjinojnë. Vendosi për veten tuaj qëllime që kanë kuptim dhe bëhuni udhëheqës globalë, që do t’i sjellin dobi njerëzimit.

Gjithçka që kemi na është huazuar nga Zoti



Disa thonë se jam një nga njerëzit më të pasur në botë, por ata nuk dinë çfarë flasin. Kam punuar shumë gjatë gjithë jetës, por nuk kam as edhe një shtëpi të vetme në emrin tim. Gjithçka është për publikun. Çdo korean në moshë madhore ka vulën e tij zyrtare, që regjistrohet në shtet, dhe e përdor për të firmosur dokumentet legale. Unë nuk e kam një vulë të tillë.

Ju mund të pyesni veten atëherë, se çfarë përfitimi kam pasur që kam punuar aq shumë duke mos ngrënë dhe duke mos fjetur, ndërsa të tjerët hanin dhe flinin. Nuk punova që të pasurohem. Paraja nuk ka kuptim për mua. Paraja që nuk përdoret për hir të njerëzimit, ose për hir të fqinjit që po vdes në varfëri, nuk është asgjë më shumë se një copë letër. Paraja e fituar me djersë duhet të përdoret gjithmonë për të dashur botën dhe për të bërë projekte në dobi të botës.

Kur dërgoj misionarë jashtë vendit, nuk u jap atyre shumë para. Prapëseprapë ata mbijetojnë kudo që shkojnë. Na duhen shumë pak gjëra që të mbijetojmë. Nëse kemi një thes gjumi (sleeping bag), është i mjaftueshëm që të flemë kudo. Ajo që ka rëndësi më shumë nuk është mënyra si jetojmë, por lloji i jetës që bëjmë. Pasuria materiale nuk është kusht për lumturi. Më trishton kur dëgjoj se fraza “të jetosh mirë” është

përkufizim i lidhur ngushtë me pasurinë materiale. Të jetosh mirë do të thotë të bësh një jetë me kuptim.

Unë vë kravatë vetëm për shërbimet e adhurimit ose për ndonjë ngjarje speciale. As me kostum nuk vishem shpesh. Kur jam në shtëpi, zakonisht vesh një pulovër. Nganjëherë mendoj se sa shumë para shpenzohen për kravatat në shoqëritë perëndimore. Kapëset e kravatave dhe kapëset e mëngëve të këmishëve të kostumit janë shumë të shtrenjta. Nëse të gjithë do të ndalonin së bleri kravata dhe do t'i përdornin paratë për hir të fqinjit që vuan urie, atëherë bota do të ishte një vend pak më i mirë për të jetuar. Gjërat e shtrenjta nuk janë medoemos të nevojshme. Imagjinoni çfarë do të ndodhte nëse do të binte zjarri në një ndërtesë. Kush do të ishte i pari që do të dilte: unë me pulovër apo ndonjëri me kravatë? Unë jam gjithmonë gati të dal.

Disa mund të mendojnë se e kursej në ekstrem. Nuk jam për të bërë banjë çdo ditë. Një herë në tri ditë është e mjaftueshme. As çorapet nuk i laj çdo ditë. Në mbrëmje, i heq dhe i vë në xhepin e pasmë, në mënyrë që të mund t'i vesh përsëri ditën tjetër. Kur jam në hotel, përdor vetëm peshqirin më të vogël, të varur në banjë. E zbraz ujin e depozitës së banjës, vetëm pasi kam urinuar tri herë aty. Përdor vetëm një pjesë të vogël të letrës higjienike, pasi e kam palosur atë tri herë. Nuk dua t'ia di nëse më quani të paqytetëruar apo të pagdhendur për këtë. Të njëjtën dëshirë për të kursyer e kam edhe gjatë ngrënies. Nuk kam interes për vaktet e ndërlikuara. Mund të kem përpara të gjitha llojet e ushqimeve ekzotike dhe llojeve e ndryshme të ëmbëlsirave, por nuk kam interes për to. Nuk e mbush plot tasin tim të orizit. Është mjaft nëse mbushet deri në tri të pestat.

Këpucët që preferoj më tepër, në Kore kushtojnë 49 000 uon (4500 lek), në një dyqan të madh me ulje. Pantallonat, që vesh çdo ditë, kam

mbi pesë vjet që i përdor. Ushqimi që më pëlqen më shumë, në Amerikë, është “McDonald’s”. Disa njerëz e quajnë atë ushqim pa vlerë dhe nuk e hanë, por mua më pëlqen ta ha atë për dy arsye: është i lirë dhe të kursen kohë. Kur i çoj fëmijët për të ngrënë jashtë, shpesh shkojmë në “McDonald’s” dhe, tani, kryetari i korporatës “McDonald’s” më dërgon kartolinë përshëndetje për çdo Viti të Ri.

Mesazhi që u jap anëtarëve tanë çdo vit është: “Shpenzoni paratë me kujdes dhe të kurseni në çdo gjë”. Nuk u them kështu që ata të kursejnë para dhe të bëhen të pasur. Dua që ata të kenë vetëdijen e kursimit, që të ndihmojnë vendin dhe të shpëtojnë njerëzimin. Nuk marrim asgjë me vete kur largohemi nga kjo botë. Të gjithë e dinë këtë, megjithatë, për një arsye apo një tjetër, njerëzit duan me çdo kusht t’i mbushin duart me sa më shumë gjëra. Kam në plan të jap gjithçka, që kam ndërtuar gjatë jetës sime, para se të largohem nga kjo botë. Mbretëria Qiellore ka thesare me bollëk, kështu që nuk është e nevojshme të çosh atje asgjë prej kësaj bote. Kur të kuptojmë se jemi duke shkuar drejt një vendi më të mirë se ky ku jemi tani, nuk kemi më nevojë të kapemi pas gjërave të kësaj bote.

Di një këngë që më ka pëlqyer gjithmonë ta këndo. Është një këngë e vjetër popullore, që e dinë shumë koreanë. Sa herë e dëgjoj më lehtësohet zemra dhe sytë më mbushen me lot. Më kujton djalërinë, kur shtrihesha nëpër fushat afër shtëpisë.

*Ti mund të thuash se do të më japësh një kurorë platini me xhevahirë,
Por një këmishë që mban erë zhul dhe që kullon djersë do të ishte më mirë.*

*Një zemër e dëlirë më gufon brenda gjoksit,
Me gjethet e shëlgut mund të bëj një flaut,
dhe trumcakët do të shoqërojnë melodinë time.*

*Ju mund të më thoni se do më jepni flori sa për të blerë gjithë botën,
Por do të më vlente më shumë një buall, që do të lëronte, në fushat e elbit, tokën.*

*Sy thet e shpresës mbijnë në gjoksin tim,
mund të flas lirshëm me lepujt,
Dhe, teksa luaj melodinë time, ditët ikin.*

Lumturia është gjithmonë duke pritur për ne. Arsyeja, që ne nuk gjejmë lumturinë, është se janë dëshirat tona që na bllokojnë rrugën. Për sa kohë që sytë i kemi të ngulur tek dëshirat tona, ata nuk shikojnë dot rrugën që duhet të ndjekin. Jemi kaq të zënë duke mbledhur thërrimet e arit në tokë, afër nesh, sa nuk shohim përgun e madh të floririt që ndodhet pak më sipër rrugës sonë. Jemi kaq të zënë me shtëniën e gjërave nëpër xhepat tanë, por nuk e kuptojmë që ata xhepa janë gjithë vrime. Nuk e kam harruar çdo të thotë të jetosh në burgun e Hëngnamit. Edhe vendi më i tmerrshëm në këtë botë është më i rehatshëm dhe më i begatë se burgu i Hëngnamit. Çdo objekt i përket Qiellit. Ne jemi veç kujdestarët e tij.

Lumturia është jetë e jetuar në shërbim të të tjerëve



Fëmijët lindin nga mishi dhe gjaku i prindërve të tyre. Pa prindër nuk do të kishte fëmijë. Megjithatë, njerëzit e kësaj bote bërtasin pro individualizmit, sikur të kishin ardhur në këtë botë vetvetiu. Vetëm ai person që nuk merr asnjë lloj ndihme, nga asnjë person, ka të drejtë të flasë për individualizëm. Nuk ka asgjë në këtë botë që vjen në ekzistencë vetëm për hir të vetes. Të gjitha qeniet janë krijuar për njëra-tjetrën. Unë ekzistoj për ty, dhe ti ekziston për mua.

Nuk ka asnjëri më budalla se një person egoist, që jeton vetëm për hir të vetes. Mund të duket sikur individi përfiton nga kjo jetë egoiste, por, përfundimisht, ajo është vetë-shkatërrim. Individi duhet të jetojë për familjen, familja për popullin, populli për botën dhe bota për Zotin.

Të gjitha shkollat që kam themeluar kanë tri moto. E para: “Jeto një jetë që nuk lëshon hije, sikur të ishte nën diellin e mesditës”. Një jetë pa hije është jetë me ndërgjegje të pastër. Kur të mbarojmë jetën këtu mbi tokë dhe të shkojmë në botën shpirtërore, e gjithë jeta do të na shpaloset para sysh, sikur të ishte duke u shfaqur një kasetë videoje. Nëse shkojmë në qiell apo në ferr, vendoset nga mënyra si jetojmë. Prandaj na duhet të jetojmë jetë të panjolllosura, të pastra, që nuk lëshojnë as hijen më të vogël.

Motoja e dytë: “Jetoni duke derdhur djersë për tokën, lot për njerëzimin dhe gjak për qiellin”. Nuk ka të gënjeshtërt në gjakun, djersën dhe lotët që derdhen njerëzit. Ka vetëm të vërtetë. Mirëpo, nuk ka kuptim a vlerë në gjakun, djersën dhe lotët që dikush i derdh për hir të vetes. Ky investim i madh duhet të derdhet për hir të të tjerëve.

Motoja e fundit është “Një familje nën Zotin!”. Ekziston vetëm një Zot, dhe të gjitha qeniet njerëzore janë vëllezër e motra. Dallimet gjuhësore, racore dhe kulturore janë më pak se një e qinda (1%). Si qenie njerëzore jemi më shumë se nëntëdhjetë e nëntë për qind (99 %) të njëjtë.

Janë katërmbëdhjetë vende ishullore në Paqësorin jugor. Kur vizitova Ishujt Marshall, e pyeta presidentin e tij: “Kjo është një tokë e bukur, por ende duhet të jetë e vështirë ta udhëheqësh këtë vend, apo jo?”

Presidenti psherëtiu dhe u përgjigj: “Popullsia jonë është vetëm gjashtëdhjetë mijë vetë, dhe toka është, mesatarisht, vetëm dy metra mbi nivelin e detit. Kështu që, një dallgë një metër, apo një ngritje e nivelit të ujit me një metër, do të përmbyste një pjesë të mirë të vendit. Sidoqoftë, problemi ynë më serioz është arsimi. Fëmijët e familjeve të pasura shkojnë për të studiuar në Amerikë ose Evropë, dhe nuk kthehen. Fëmijët e familjeve të varfra nuk kanë shkollë për t’u arsimuar si duhet, kështu që as fëmija më i shkëlqyer nuk mund të trajnohet si duhet për t’u bërë udhëheqës. Shqetësimi, për vende ishullore si ky yni, është se nuk jemi në gjendje të rrisim udhëheqës, që do të na drejtojnë në të ardhmen”.

Pasi dëgjova ankesën e tij, krijova, për hir të fëmijëve të këtyre vendeve ishullore, Shkollën e Mesme të Paqësorit në Kona, në Ishujt Havai. Kjo shkollë siguron arsim tetëvjeçar për fëmijët e këtyre vendeve të gjithë Paqësorit dhe i ndihmon ata të futen në kolegje. Ne u sigurojmë udhëtimin vajtje-ardhje në Havai, pagesën e shkollës, fjetjen, madje edhe kompjuterët, në mënyrë që ata të marrin arsimimin më të mirë.

Kemi bashkëngjitur vetëm një kusht për t'u futur në këtë shkollë. Pasi të mbarojnë, duhet të kthehen në vendet e tyre, në shërbim të kombeve dhe popujve të tyre.

Të jetosh për hir të të tjerëve kërkon të sakrifikosh, herë pas here. Disa vjet më parë, një nga misionarët e kishës sonë po udhëtonte nëpër Amerikën e Jugut kur vendi u godit nga një tërmet i madh. Gruaja e tij erdhi me vrap tek unë me fytyrë të verdhë dyllë.

“Çfarë duhet të bëj?,- më pyeti me lot në sy.- Jam shumë e shqetësuar, nuk di çfarë të bëj”.

Ju mund të habiteni me përgjigjen time. Në vend që ta prekja lehtë mbi shpatulla dhe ta ngushëlloja, i bërtita: “Je e shqetësuar për burrin tënd, apo sa jetë mund të jetë në gjendje të shpëtojë ai në atë zonë të shkatërruar?”.

Ishte e natyrshme që ajo të shqetësohej për sigurinë e të shoqit. Por, meqë ishte gruaja e një misionari, duhej të ishte shqetësuar për gjëra më të larta. Në vend që të lutej vetëm për sigurinë e burrit të saj, duhet të ishte lutur që, ai, të mund të shpëtonte sa më shumë jetë që të ishte e mundur.

Asgjë nuk ekziston për hir të vetvetes. Zoti nuk e krijoi botën të atillë. Burri ekziston për gruan, dhe gruaja ekziston për hir të burrit. Natyra ekziston për hir të njerëzimit dhe njerëzimi ekziston për hir të natyrës. Të gjitha qeniet e krijuara në këtë botë ekzistojnë për hir të partnerit të vet. Është një aksiomë e Qiellit që, çdo qenie ekziston për hir të partnerit të vet.

Lumturia është e mundur vetëm në marrëdhënie me një partner. Imagjinoni dikë që, ka jetuar gjithë jetën si këngëtar, të shkojë në një ishull të pabanuar dhe të këndojë me sa ka në kokë. Nëse nuk do të ketë njeri që ta dëgjojë, ai nuk do të jetë i lumtur.

Të kuptojmë se ekzistojmë për hir të të tjerëve, është një arritje e madhe, që ndryshon jetët tona. Kur arrijmë të kuptojmë se jeta jonë nuk është vetëm e jona, por është thënë të jetohet për hir të tjetrit, fillojmë të ndjekim një rrugë, që ndryshon nga e mëparshmjia.

Ashtu siç nuk do të ishe i lumtur nëse këndon i vetëm, ashtu edhe, nuk ka gëzim pa një partner. Edhe gjëja më e vogël, edhe ajo më e vështira, mund t'ju sjellë gëzim, vetëm, kur e bëni atë për dikë tjetër.

Të ëndërrosh një botë paqësore



Për vite me radhë kam bërë thirrje për një botë ku të gjitha fetë të jetojnë së bashku, si një; të gjitha racat si një e vetme dhe të gjitha kombet të ekzistojnë si një komb. Mirëpo, për mijëra vite, historia ka parë rritjen e vazhdueshme të ndarjeve. Sa herë është pranuar një fe e re apo sa herë një regjim i ri ka ardhur në fuqi, aq më shumë kufij janë vënë dhe aq më shumë luftëra janë bërë. Por, tani jetojmë në një epokë globalizmi. Për hir të së ardhmes na duhet të bëhemi bashkë.

Një mënyrë që unë propozoj për lehtësimin e kësaj gjëje, është Autostrada Ndërkombëtare e Paqes; një sipërmarrje tepër e madhe. Kjo do të bashkojë Korenë me Japoninë, nëpërmjet një tuneli nënujor, dhe do të krijojë një urë ose tunel përmes Ngushticës së Beringut, ku ndahet Rusia me Amerikën e Veriut. Këto lidhje madhështore mund të bashkojnë botën. Kur të përfundojë kjo autostradë, do të jetë e mundur të udhëtohet me makinë nga Kepi i Shpresës së Mirë në Afrikë, deri në Santiago, Kili, dhe nga Londra në Nju jork. Nuk do të ketë postbllloqe; e gjithë bota do të jetë e ndërlidhur si enët e gjakut të trupit të njeriut.

Bota do të bëhet një komunitet i integruar, dhe gjithkush do të jetë në gjendje të udhëtojë lirisht përmes kufijve ndërkombëtarë. Kufijtë, që do të lejojnë çdo kalimtar, do ta humbasin funksionin e tyre. Diçka e ngjashme do të jetë e vërtetë edhe për fetë. Me rritjen e frekuencës së

shkëmbimeve midis feve, do të vijë një kuptim më i madh reciprok, konfliktet do të zhduken dhe muret e ndarjes do të rrëzohen.

Kur tipa të ndryshëm njerëzish do të jetojnë së bashku në një komunitet të vetëm global, barrierat midis racave do të bien. Ndërveprimet midis racave do të ndodhin, pavarësisht nga dallimet e jashtme dhe ato gjuhësore. Ky revolucion kulturor do ta çojë botën drejt bashkimit.

Rruga e lashtë e Mëndafshit nuk ishte thjesht një rrugë tregtie, që e përdornin njerëzit për të shitur mëndafsh e për të blerë erëza. Ishte, në të njëjtën kohë, një mjet që popujt e Lindjes të takoheshin me popujt e Perëndimit dhe, që, budizmi të takohej me islamizmin dhe krishterimin. Këto kultura të ndryshme u përzierin dhe lindën një kulturë të re. Autostrada Ndërkombëtare e Paqes do të luajë një rol të ngjashëm në shekullin e njëzetentë.

Roma mundi të begatohet, sepse të gjitha rrugët të çonin në Romë. Kjo ilustron rëndësinë që kanë rrugët. Kur ndërtohet një rrugë, njerëzit e përdorin për të udhëtuar. Përdoret gjithashtu për të transportuar kulturën dhe ideologjinë. Prandaj, ndërtimi i një rruge mund të ndryshojë kursin e historisë. Kur të përfundojë Autostrada Ndërkombëtare e Paqes, bota mund të jetë, fizikisht, e lidhur si një trup.

Nuk gjej fjalë me të cilat ta theksoj sa duhet rëndësinë e bashkimit të botës në një të vetme. Disa mund të mendojnë se kjo është një ide që e parakohshme. Por besimtarët janë ata që parashikojnë të ardhmen dhe përgatiten për të. Prandaj, është e natyrshme që jemi përtej kohës që jetojmë. Bota mund të mos na kuptojë dhe mund të na bëjë të vuajmë, por besimtarët duhet të durojnë, që të udhëheqin rrugën drejt së ardhmes.

Përfundimi i Autostradës Ndërkombëtare të Paqes do të kërkojë bashkëpunimin e shumë kombeve. Kina, e cila ka qenë viktimë e agresionit japonez, mund të mos e mirëpresë idenë e lidhjes me Japoni-

në me anë të një autostrade. Megjithatë, Japonia dhe Koreja nuk lidhen dot me pjesën tjetër të botës pa kaluar përmes Kinës, kështu që duhet të bëjmë përpjekje për të fituar besimin e Kinës.

Kush do ta bëjë këtë? Personat që do të marrin pronësinë shpirtërore mbi Autostradën Ndërkombëtare të Paqes në shekullin e njëzetentë, duhet të vihen në krye të këtyre përpjekjeve.

Po në lidhje me urën e ngushticës së Beringut? Kjo do të kushtojë jashtëzakonisht shumë, por kjo nuk duhet të na shqetësojë. Shuma e parave që Shtetet e Bashkuara kanë përdorur në Irak do të ishte më se e mjaftueshme për të ndërtuar një urë të tillë. Duhet të ndalojmë së bëri luftëra dhe së shkaktuari vuajtje njerëzve. Është e mbrapshtë të fillosh luftëra dhe të prishësh pa mend qindra miliarda dollarë. Ka ardhur koha t'i kthejmë shpatat në plugje dhe heshtat në drapinj.

Autostrada Ndërkombëtare e Paqes do t'i japë fund pabarazisë së tanishme, duke krijuar mundësi përdorimi të të gjitha burimeve natyrore dhe njerëzore. Kjo do të sjellë një nivelim të pasurisë. Nivelim do të thotë, që u merret pak vendeve që janë më lart dhe u shtohet atyre që janë më poshtë. Si rezultat, të dy kanë të njëjtën lartësi. Kjo do të kërkojë sakrificë nga ana e atyre që kanë pasuri materiale ose njohuri më të mëdha. Ndërtimi i botës së paqes nuk mund të bëhet me një veprim dhurimi apo me një bamirësi. Vetëm dashuria e sinqertë dhe sakrifica e vazhdueshme është në gjendje të krijojë një botë të paqes. Duhet të jemi të gatshëm të ofrojmë gjithçka.

Ndërtimi i Autostradës Ndërkombëtare të Paqes bën shumë më tepër se sigurimi i rrugës fizike të komunikimit. Qeniet njerëzore janë krijuar në mënyrë që mendja dhe trupi i tyre të bëhet një. Diçka e ngjashme është e vërtetë edhe për botën në të cilën jetojmë. Bota mund të bashkohet plotësisht, vetëm kur të ekzistojnë të dyja: komunikimi

fizik dhe komunikimi i zemrës.

Për këtë arsye unë kam punuar shumë vite për reformimin dhe rinovimin e Kombeve të Bashkuara. Sigurisht që Kombet e Bashkuara kanë bërë shumë për paqen botërore. Të gjithë koreanët i janë mirënjohës për përpjekjet e saj për ruajtjen e lirisë gjatë Luftës Koreane. Megjithatë, sot, gjashtëdhjetë vite pas themelimit të tyre, Kombet e Bashkuara po e humbasin drejtimin e qëllimit origjinal dhe janë në rrezik për t'u kthyer në një organizatë që punon vetëm për interesa të disa vendeve të fuqishme.

Në vitin 2005 unë themelova Federatën e Paqes Universale në Nju Jork dhe, menjëherë pas kësaj, nisa një turne botëror në njëqind e njëzet vende për të mbajtur një mesazh paqeje mbi të ardhmen e Kombeve të Bashkuara dhe Botës. Kombet e Bashkuara u krijuan për të zgjidhur konfliktet që lindin në botë, kështu që duhet të vënë interesat e botës përpara interesave të njërës anë, apo të tjetrës. Kur një vend i fuqishëm ngul këmbë në të vetën dhe përdor forcën për ta arritur këtë, kjo çon vetëm drejt konfliktit të mëtejshëm. Fatkeqësisht, Kombet e Bashkuara të ditëve të sotme nuk janë në gjendje të bëjnë shumë në situata të tilla.

Në këtë këndvështrim, kam propozuar ristrukturimin e Kombeve të Bashkuara, si një institucion me dy dhoma. Përveç Asamblesë së Përgjithshme, do të ishte edhe një asamble, apo këshill, fetar ose kulturor. Ky trup do të përbëhej nga udhëheqës fetarë të respektuar në fusha të tilla, si feja, kultura dhe arsimiti. Anëtarët e kësaj asambleje ndërfaqetare do të duhet të tregojnë aftësi për të kapërcyer interesat e kufizuara të një feje dhe të kulturave të veçanta, dhe të flisnin për qëllimet shpirtërore dhe morale të mbarë njerëzimit. Jam që, të dyja dhomat, duke punuar së bashku, në respekt dhe bashkëpunim reciprok, do të ishin në gjendje të bënin hapa të mëdha përpara në sjelljen e një bote të paqes.

Disa mund të kundërshtojnë këtë duke thënë: “Pse duhet të përfshihen në çështjet e botës njerëzit fetarë?”. Përgjigjja ime është se bota sot është në një periudhë, kur pjesëmarrja e njerëzve fetarë është vendimtare. Ata që kanë arritur një vetë-ndërgjegjësim të thellë, në sajë të praktikave fetare, nevojiten tani, më shumë se kurrë.

Janë vetëm njerëzit e vërtetë fetarë ata që mund të ngrihen kundër padrejtësisë dhe ligësisë së botës dhe që mund të aplikojnë dashurinë e vërtetë. Vetëm kur dituria dhe përvoja e udhëheqësve politikë të kombinohet me urtësinë e udhëheqësve ndërfetarë, bota do të jetë në gjendje të gjejë rrugën drejt paqes së vërtetë.

Çdo ditë, me vendosmëri të rinovuar, e rregulloj kursin e jetës sime për të arritur këtë qëllim. Lutja ime është që: çdo njeri mbi tokë do të rilindë si një qytetar global paqedashës, duke kapërcyer barrierat e fesë, ideologjisë dhe racës.